

VENDIM
Nr. 817, datë 18.12.2019

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE TE AGJENCIA SHETETËRORE E KADASTRËS, TË PASURISË 14/86, ZONA KADASTRALE 8571, DHE NGA MINISTRIA E DREJTËSISË TE DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE, TË PASURISË 16/51-8, ZONA KADASTRALE 8571, NJËSIA ADMINISTRATIVE LUSHNJË, DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 448, DATË 16.6.2005, TË NDRYSHUAR, DHE NR. 818, DATË 6.12.2006, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve tek Agjencia Shtetërore e Kadastrës, të pasurisë 14/86, zona kadastrale 8571, me sipërfaqe truall 570 m² dhe ndërtesë 265 m², Njësia Administrative Lushnjë, sipas hartës kadastrale bashkëlidhur këtij vendimi, me qëllim ushtrimin e funksioneve administrative të Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Lushnjë.

2. Pasuria e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 818, datë 6.12.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve”, të ndryshuar.

3. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Drejtësisë te Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të pasurisë 16/51-8, zona kadastrale 8571, njësi me sipërfaqe 125 m², Njësia Administrative Lushnjë, sipas hartës kadastrale dhe planimetrisë bashkëlidhur këtij vendimi, me qëllim ushtrimin e funksioneve administrative të Agjencisë Tatimore Lushnjë.

4. Pasuria e përmendur në pikën 3, të këtij vendimi, hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 448, datë 16.6.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, të ndryshuar, dhe i shtohet listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 818, datë 6.12.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve”, të ndryshuar.

5. Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve u ndalohet të ndryshojnë destinacionin e përdorimit, t’i tjetërsojnë ose t’ua japin në përdorim të tretëve pasuritë e përcaktuara në pikat 1 dhe 3 të këtij vendimi.

6. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

